Në bazë të nenit 15 të Ligjit për Zonat Zhvillimore Industriale Teknologjike („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 14/07, 103/08, 130/08, 139/09, 156/10, 127/12, 41/14, 160/14, 72/15, 129/15, 173/15, 192/15, 217/15, 30/16, 83/18 dhe 83/18, si dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 13/23, 59/25 dhe 154/25), dhe nenit 21 të Statutit të Drejtorisë për Zonat Zhvillimore Industriale Teknologjike, Drejtori i Drejtorisë për ZZHTI, më datë 01.08.2025, miratoi sa vijon:

PROCEDURË

për hartimin e vërtetimit për përmbushjen me kohë dhe në mënyrë cilësore të kontratave të lidhura nga Drejtoria për Zonat Zhvillimore Industriale Teknologjike.

QËLLIMI I PROCEDURËS

Qëllimi i kësaj procedure është të përcaktojë një procedurë të qartë për hartimin dhe nënshkrimin e vërtetimit për përmbushjen me kohë dhe në mënyrë cilësore të kontratave, në përputhje me Ligjin për Prokurim Publik dhe sipas nevojave të personave juridikë, me qëllim sigurimin e transparencës dhe përgjegjshmërisë së Drejtorisë për Zonat Zhvillimore Industriale Teknologjike (në tekstin e mëtejmë: Drejtoria).

Neni 1

Personi i autorizuar, i cili është përgjegjës për administrimin dhe realizimin e kontratës nga procedura e prokurimit publik, e harton vërtetimin me kërkesë të bartësit të prokurimit dhe e nënshkruan në pjesën e paraparë për hartuesin.

(Modeli 1)

- **Vërtetimi duhet të përmbajë informacionet në vijim:**

- Emri dhe adresa e operatorit ekonomik
- Lënda e kontratës
- Numri dhe data e kontratës
- Vlera e kontratës
- Kohëzgjatja e kontratës
- Data e realizimit të plotë të kontratës
- Përshkrimi i obligimeve të realizuara
- Të dhëna të tjera (nëse ka), përshkrim ose sqarim.

KONTROLLI

Neni 2

Vërtetimi i dorëzohet Ndihmës Udhëheqësit të Sektorit për Prokurim Publik, në kuadër të Sektorit për Çështje të Përgjithshme, Normative dhe Prokurim Publik, në rastet kur vërtetimi lëshohet në

lidhje me një kontratë të prokurimit publik, me qëllim që të konfirmojë se vërtetimi buron nga një kontratë e prokurimit publik, në pjesën e paraparë për kontrolluesin.

MIRATIMI

Neni 3

Vërtetimi i dorëzohet Udhëheqësit të Sektorit për Menaxhimin e Burimeve për miratim.

Udhëheqësi e nënshkruan vërtetimin në pjesën e paraparë për miratuesin.

Neni 4

Pas përfundimit të të gjitha kontrolleve, vërtetimi i dorëzohet personit përgjegjës në Drejtori për nënshkrim përfundimtar.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PERFUNDIMTARE

Neni 5

Procedura hyn në fuqi në ditën e miratimit të saj.

Me hyrjen në fuqi të kësaj Procedure, shfuqizohet Procedura e regjistruar me numër arkivor 03-270/2, të datës 07.02.2025.

Shtojcë:
Modeli 1 (Vërtetim për përmbushjen me kohë dhe në mënyrë cilësore të kontratave të lidhura nga Drejtoria për Zonat Zhvillimore Industriale Teknologjike).

Директор

D.r Goce Dimovski

Hartoi: Zoran Spandzhevski

ТИРЗ
РАСТЕМЕ ЗАЕДНО

Број/ Numër _____

Датум/Data _____

ДИРЕКЦИЈА ЗА ТЕХНОЛОШКИ ИНДУСТРИСКИ РАЗВОЈНИ ЗОНИ/ DREJTORIA PËR ZHVILLIM TEKNOLOGJIK-INDUSTRIAL TË ZONAVE

Бул. Партизански одреди, бр. 2/ Bul. „Partizanski Odredi", nr. 2
П.Фах 311, 1000 Скопје/ Kutia postare 311, 1000 Shkup
Република Северна Македонија/ Republika e Maqedonisë së Veriut

Врз основа на Барање заведено под архивски број _____ поднесено до Дирекцијата, се издава следнава:/
Në bazë të Kërkesës së regjistruar me numër arkivor të paraqitur pranë Drejtorisë, lëshohet si vijon:

Образец 1/ Formulari 1

ПОТВРДА / VËRTETIM за навремено и квалитетно извршување на договори склучени од Дирекцијата за Технолошки индустриски развојни зони për realizimin në kohë dhe me cilësi të kontratave të lidhura nga Drejtoria për Zhvillim Teknologjik-Industrial të Zonave.	
Предмет на договорот / Lënda e kontratës	
Број и датум на договорот / Numri dhe data e kontratës	
Назив и адреса на економскиот оператор / Emri dhe adresa e operatorit ekonomik	
Вредноста на договорот / Vlera e kontratës	
Времетраење на договорот / Kohëzgjatja e kontratës	
Датум на целосно реализирање на договорот / Data e realizimit të plotë të kontratës.	
Опис на извршените обврски / Përshkrimi i obligimeve të përmbushura	

INTERCERT ISO 37001 ABMS CERTIFIED
INTERCERT ISO 9001 QMS CERTIFIED

1

Други податоци (ако ги има), опис или појаснување / Të dhëna të tjera (nëse ka), përshkrim ose sqarim	

Директор на
Дирекција за ТИРЗ

/Drejtori I Drejtoris për ZZHTI

Изготвил _____ _____
Përgatiti

Контролирал _____
Kontrolloi

Одобрил _____